

## INFORMACION MBI PËRKRAHJEN E HERSHME NË GJUHË PËR PRINDËRIT/KUJDESTARËT

---

### Përkrahje e hershme në gjuhë

Steiermarku ka lidhur përsëri një marrëveshje me shtetin austriak sipas Art. 15a B-VG. Qëllimi është marrja e masave për përkrahjen e hershme në gjuhë në kopshtet e fëmijëve për vitet 2015/16 deri më 2017/18.

Këto masa synojnë të lehtësojnë hyrjen në shkollën fillore, të përmirësojnë shanset e fëmijëve për edukim dhe në vazhdim të mundësojnë edhe një hyrje më të mirë në jetën profesionale.

### Gjuha si pjesë e edukimit

Edukimi gjuhësor dhe përkrahja gjuhësore janë detyra të caktuara me ligj në planin e edukimit. Kështu janë pjesë e detyrës së përgjithshme për edukim dhe janë ndër veprimet elementare të edukimit.

Përkrahja gjuhësore përfshin përditshmërinë e tërë në institucionet e kujdesjes dhe të edukimit të fëmijëve.

### Verifikimi i aftësive gjuhësore

Verifikimet e aftësive gjuhësore informojnë për nivelin gjuhësor të fëmijëve dhe nëse kanë nevojë për përkrahje në gjuhë.

Fokusi qëndron mbi verifikimin e kompetencës gjuhësore të fëmijës me ndihmën e një testi të veçantë.

### Testi për verifikim „BESK (DaZ) KOMPAKT“

Fëmijët do të vëzhgohen në institucionet e përkujdesjes për fëmijë më anë të një testi. Ky test shërben për verifikimin e kompetencës gjuhësore të fëmijëve me gjermanisht si gjuhë të parë (BESK) nga mosha tre e gjysëm dhe për fëmijët me gjermanisht si gjuhë të dytë nga mosha katër e gjysëm.

Fëmijët të cilët mbas këtij vëzhgimi shfaqin nevojë për mbështetje në zhvillimin gjuhësor, duhet të përkrahen në atë drejtim. Qëllimi është të zotërojnë sa më mirë gjuhën e mësimdhënies, d.m.th. gjermanishten, kur hyjnë në shkollë. Kjo bëhet sipas „Standardeve të edukimit për kompetencën gjuhësore dhe kompetencën në të folurin në fillim të vijimit të detyrueshëm të shkollës“.

### Vëzhgimi

Vëzhgimi është pjesë elementare e punës së përditshme të pedagogëve në kopshtin e fëmijëve.

Ofron mundësinë për të njohur më mirë çdo fëmijë dhe për të verifikuar ndër të tjera nëse ka nevojë për përkrahje në zhvillimin e gjuhës.

Të dhënat e marra gjatë vëzhgimit tregojnë aftësitë, pikat e forta dhe kompetencat e veçanta të fëmijës dhe ofrojnë një pikënisje për të krijuar një ambient që përkrah zhvillimin gjuhësor të fëmijës.

### Si bëhet vëzhgimi?

Vëzhgimi bëhet në situata të natyrshme në përditshmërinë e kopshtit, duke luajtur dhe në një ambient sa më të përshtatshëm gjuhësor.

Si parim, përditshmëria në kopsht ofron mundësi për të folur dhe oferta gjuhësore për gjithë grupin, kështu që fëmijët mund ta mësojnë me sukses gjermanishten si gjuhë të parë por edhe si gjuhë të dytë.

Për ta shoqëruar individualisht çdo fëmijë në zhvillimin e tij, pedagogët e kopshtit i kontrollojnë dy herë në vit aftësitë gjuhësore. Së pari në vjeshtë (tetor/nëntor) dhe tek fëmijët me nevojë për përkrahje gjuhësore bëhet edhe një vëzhgim tjetër në pranëverë (prill/mai).

## Rezultatet

Rezultatet e testit tregojnë aftësitë e fëmijës në fushët e ndryshme të kompetencës gjuhësore.

Nëse nga rezultatet e testit del që një fëmijë ka nevojë për përkrahje gjuhësore, ofrohen masa të veçanta që i marrin parasysh interesat e fëmijës.

## Masa të tjera të përkrahjes

Pjesa më e madhe e përkrahjes së hershme në gjuhë në kopsht mbulohet nga resurset në dispozicion të personelit.

Në varësi të numrit të fëmijëve me nevojë për përkrahje gjuhësore në institucionet e edukimit, qeveria e Steiermarkut ofron:

- Personel shtesë për përkrahjen gjuhësore që mbështet fëmijët në vend në mënyre integrale.
- Angazhohen shoqërues dhe shoqëruese që i ndihmojnë, përkrahin dhe shoqërojnë fëmijët të cilët nuk e kanë gjermanishten si gjuhë të parë.
- Përkthyes dhe përkthyesë për gjuhë të ndryshme në kuadër të verifikimit të aftësive gjuhësore të fëmijëve në gjuhën e tyre të parë.
- Këshilla, ndihmë dhe kualifikim të mëtejshëm të stafit të specializuar nga specialistë për përkrahjen e hershme në gjuhë.

## Vlerësimi i gjuhëve të tjera dhe gjermanishtja si gjuha e dytë

Vlerësimi i gjuhës së parë dhe përkrahja në të janë pjesë përbërëse dhe baza e mësimi të gjuhës së dytë. Ajo i jep fëmijës besim dhe siguri në situata të reja dhe ia forcon vetbesimin.

*„sepse gjuha është çelësi i botës“*